Breaking News:
DVP Shkodër – Arrestohet 1 shtetas
Vlorë/Vijon megaoperacioni policor i koduar "Tempulli"
Tiranë – Policia Rrugore, apel për respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor
DVP Dibër – Vihet në pranga 1 shtetas, procedohen në gjendje të lirë 3 të tjerë
Durrës – Finalizohet pas një hetimi dymujor, operacioni policor antidrogë i koduar "Grupi"




Lajmet Operacionet

*09/01/2024*

# Tiranë – Sekuestrohen Armë Dhe Municion Luftarak Në Fshatin Vilëz, Shpallet Në Kërkim Poseduesi

Tiranë

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 4, angazhim maksimal në kuadër të operacionit mbarëkombëtar "Sundimi i ligjit", për goditjen e veprimtarive kriminale në fushën e mbajtjes pa leje të armëve dhe vënien përpara përgjegjësisë penale të shtetasve që i posedojnë ato.

Sekuestrohen granata, krehra pistolete dhe kallashnikovi, municion luftarak, pistoletë dhe një kapuç si maskë.

Shpallet në kërkim 50-vjeçari që i mbante ato në banesë.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 4, në vijim të punës për garantimin e sundimit të ligjit në territor, pas informacionit të marrë se në fshatin Vilëz, një shtetas mbante armë shpërthyese dhe sende të tjera të paligjshme, në banesë, kanë organizuar punën në kuadër të operacionit mbarëkombëtar "Sundimi i ligjit" dhe si rezultat kanë ushtruar kontroll në banesën e shtetasit D. V., 50 vjeç, banues në fshatin Vilëz, Zall Bastar.

Gjatë kontrollit në banesën e 50-vjeçarit, shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar një pistoletë, katër granata, krehra pistolete, krehra kallashnikovi dhe municion luftarak, që dyshohet se i posedonte ky shtetas.

Vijon puna për kapjen e tij.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme.

## angazhimpërkushtimsakrificë👮🚔
## tëvendosurkundërkrimit✅
## nëçdoskajtëvendit🇦🇱
## nëshërbimtëqytetarëve👮🤝🧑
## denonconë112📞 ✅

Vlorë – Finalizohet operacioni policor i koduar "Storm 11"
Lezhë – Vihen në pranga 2 shtetas, procedohen në gjendje të lirë 1 tjetër, për dhunë ndaj familjarëve

Kërko
Enter a word for search

Komisariati Dixhital
GET IT ON Google Play
Download on the App Store

Arkiva
Select Month

Linqe
- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2024 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.